



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 11, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 2093 Prot., datë 30.03.2023, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hartuar “*Projektudhëzuesin standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median*”, i cili synon standardizimin e marrëdhënies së gjykatave me publikun dhe median, si dhe rritjen e transparencës, besimit të publikut dhe të kuptueshmërisë nga publiku dhe media të veprimtarisë gjyqësore.

Në kuadër të hapave konkret për të realizuar këtë proces të rëndësishëm, me qëllim mbarëvajtjen e një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës, janë realizuar konsultime me këshillat e gjykatave, gjyqtarët e mediave. Gjithashtu, në datën 24 mars 2023, është prezantuar para përfaqësuesve të mediave projektudhëzuesi duke u kërkuar mendime dhe opinione me qëllim gjetjen e mekanizmave efikase që vendosin ura të reja bashkëpunimi dhe forcojnë dialogun midis sistemit gjyqësor dhe medias.

Në vijim të konsultimeve të ndërmarra nga KLGJ-ja për këtë projektudhëzues, është parashikuar të zhvillohet takimi radhës, në të cilin do të jenë të pranishëm përfaqësuesit e mediave si dhe përfaqësues nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky takim ka për qëllim marrjen e komenteve dhe rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e projektudhëzuesit. Lidhur me datën dhe vendin e zhvillimit të këtij takimi, do t’ju njoftojmë për pjesëmarrje, sapo të konkretizohet një datë e përshtatshme për të gjitha palët.

Gjithashtu, ju informojmë se afati përfundimtar i konsultimeve do të jetë në varësi të ecurisë të këtij procesi dhe kohës së arsyeshme që i duhet palëve të interesuara për dërgimin e rekomandimeve.

Bashkëlidhur, po ju vëmë dispozicion draftin e *“Projektudhëzuesit standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”*.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!